



BASHKIA
TIRANË

KESHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 77, datë 26.07.2017

PËR

“MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË TË DISA PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE QË DO TË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E DETYRAVE TË SAJ FUNKSIONALE NË FUSHËN E ZHVILLIMIT URBAN DHE INSTRUMENTEVE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT, SI DHE PËRDORIMIT SA MË EFIKAS TË TIJ”.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja (b) dhe pika 1/1.2, nenit 23, pika 14 dhe nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar; nenit 3 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar; pikës 6 dhe pikës 14, paragrafi i dytë i vendimit nr. 500, datë 14.8.2001 të Këshillit të Ministrave “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar; pikës 1, shkronja (a) të udhëzimit nr.15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të disa pronave të paluajtshme shtetërore që do të përdoren për ushtrimin e detyrave të saj funksionale në fushën e zhvillimit urban dhe instrumenteve të planifikimit të territorit, si dhe përdorimit sa më efikas të tij, sipas formularëve bashkëlidhur.
2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI